

RRJETI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI



AKSESI I VENDIMEVE GJYQËSORE NGA FUSHËN E MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Botues: Koalicioni "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara" MARGJINAT Shkup, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi

Autore: Aleksandra Cvetanovska

Redaktore: Biljana Kotevska

Përkthimi: Gramoz Shabani

Dizajni grafik: Bojana Micevska

Shtypi: Kontura

Tirazhi: 100

Shkup, janar 2021

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

347.95:342.72/.73.037]:005.332.5(497.7)(047.31)

CVETANOVSKA, Aleksandra

Aksesi i vendimeve gjyqësore nga fushën e mbrojtjes nga diskriminimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut : dokument për politika publike / [autore Aleksandra Cvetanovska]. - Shkup : Koalicioni Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara, 2021. - 23 str. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 22-23

ISBN 978-608-4803-32-4

a) Заштита од дискриминација -- Судски одлуки -- Достапност --
Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 53168901



RRJETI PËR
MBROJTJE NGA
DISKRIMINIMI



FOUNDATION | ФОНДАЦИЈА
OPEN | ОТВОРЕНО
SOCIETY | ОПШТЕСТВО
MACEDONIA | МАКЕДОНИЈА

Projekti "Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi – Avancimi i barazisë për vëzhgimit dhe fuqizimit të sistemit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi" është financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni. Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorit dhe grantistit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i reflekton pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Përmbajtja

- 1** Regjistrimi i lëndëve nga fusha e mbrojtjes së të drejtës për barazi në përputhje me Rregulloren e procedurës së gjykatës dhe praktikën e regjistrimit në gjykata
 - 1.1** Procedurat në lidhje me shkeljen e së drejtës për barazi në marrëdhëniet e punës të evidentuara dhe të regjistruara me shenjën MP
 - 1.2** Procedurat në lidhje me shkeljen e së drejtës për barazi të evidentuar në regjistrin P1 dhe P4
- 2** Pasqyrë e disponueshmërisë së vendimeve gjyqësore për mbrojtjen e së drejtës për barazi në portalin gjyqësor www.sud.mk
- 3** Konkludime dhe rekomandime
- 4** Lista e vendimeve të analizuar gjyqësore të vendit

Hyrje

Gatishmëria e organeve gjyqësore për qasje të hapur, të papenguar të publikut në vendimet e gjykatave është një hap drejt sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies dhe është gjithashtu një presion publik për vendimmarrje të ligjshme. Sigurimi i një aksesit të papenguar në publikimin e gjykimeve, dhe në disa raste në shkresat e lëndëve, sjell një numër përfitimesh. Në rastet kur palët në kontestet dhe përfaqësuesit e tyre po përgatiten të fillojnë procedurat, rishikimi i praktikës gjyqësore dhe pikëpamjet e gjykatave për çështje të njëjta ose të ngjashme është me rëndësi të madhe për ta dhe procedurat e tyre. Një nga përfitimet më domethënëse është kontrolli publik i gjyqtarëve kur shpallin gjykimet, dhe kështu presioni për të përgatitur gjykime cilësore. Disa shtete nuk kanë praktikë fare të publikojnë aktgjykime. Shpesh për arsye praktike, të tilla si mungesa e burimeve për kopjim dhe publikim, dhe disa nuk publikohen për shkak të privatësisë dhe konfidencialitetit^[1].

Më se e rëndësishme është të vendoset një baraspeshë midis së drejtës për mbrojtjen e të dhënave në vendimet gjyqësore dhe transparencës së sistemit të drejtësisë në vlerësimin e të dhënave që duhet të bëhen publike. Në shumë vende, ligjet dhe praktikat kërkojnë anonimizim ose pseudonimizim të vendimeve gjyqësore para se të publikohen.^[2] Detyrimi i gjykatave në këtë qasje është të zhvillojnë mjete që do të mundësojnë përpunimin e të dhënave, d.m.th. të arritshme lehtësisht, me fjalë kyçe, datën e vendimit, ligjin që është zbatuar, etj.

Transparenca e gjykatave në lidhje me mundësinë e marrjes së vendimeve gjyqësore nuk mund të analizohet vetëm nga publikimi i aktgjykimeve, por edhe nga qasja në to, d.m.th. nëse ato janë lehtësisht të kërkueshme, të arritshme dhe të publikuara në kohë. Në pasqyrën e përgjithshme, është e nevojshme të merret parasysh publikimi i raporteve për punën e gjykatave, në mënyrë që të njihet publiku me të dhënat statistikore dhe përmbledhjen e aktgjykimeve të rëndësishme në një fushë të veçantë.

Mënyra në të cilën vendimet e gjykatës janë në dispozicion në RMV nuk ofron një pasqyrë të plotë dhe të lehtë. Mungesa vërehet në procesin e përpunimit të të dhënave dhe mungesa e statistikave gjyqësore në një fushë të caktuar. Në Strategjinë për reforma të sektorit gjyqësor për periudhën 2017-2020 thotë se mungesa e praktikës për publikimin e plotë të të gjitha aktgjykimeve ka filluar të tejkalohet me vendosjen e plotë në funksion të portalit të ri të centralizuar www.sud.mk, i cili e mbulon Këshillin gjyqësor të RMV dhe të 34 gjykatat në vend, si dhe që siguron kështu një bazë të dhënash funksionale të gjykatave me mundësi për kërkim^[3].

1 Resource Guide on Strengthening Judicial Integrity and Capacity, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2011, gjendet në: https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/ResourceGuideon-StrengtheningJudicialIntegrityandCapacity/11-85709_ebook.pdf

2 THE 2020 EU JUSTICE SCOREBOARD, Komisioni Evropian, Luksemburg, 2020, gjendet në: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/justice_scoreboard_2020_en.pdf

3 Strategjia për reforma në sektorin e gjyqësorit për periudhën 2017 – 2020, Ministria e Drejtësisë, faqe 13, gjendet në: https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjia%20i%20akciski%20plan_MK-web.pdf

Ky dokument e hulumton funksionalitetin e sistemit për kërkim të vendimeve gjyqësore në fushën e mbrojtjes së të drejtës për barazi në vend, ndërsa analizon kornizën ligjore për evidentimin dhe regjistrimin e lëndëve në gjykata. Dokumenti do të adresojë paaftësinë e vendimeve gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi për t'u kërkuar në bazë diskriminuese, format dhe llojet e diskriminimit dhe të dhëna të tjera, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme në raste të tilla dhe është një pengesë për aftësinë për të përpunuar të dhëna dhe për të analizuar praktikën gjyqësore. Pjesa e parë e dokumentit adreson rregulloren ligjore për regjistrimin e lëndëve gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi dhe praktikën aktuale të gjykatave në vend. Në pjesën e dytë, përmes testimit në portalin sud.mk, paraqitet disponueshmëria praktike e vendimeve gjyqësore. Procesi përdor hulumtimin e legjislacionit për ngritjen e çështjeve, dhe metoda përshkruese përshkruan situatën me ngritjen e çështjeve për mbrojtjen e të drejtës për barazi në gjykata të ndryshme. Të dhëna për numrin e procedurave gjyqësore në bazë të diskriminimit/shkeljes së të drejtës për barazi të kryer në periudhën nga 01.01.2011 deri më 31.12.2019 të mbledhura nga Shoqata e avokatëve të rinj maqedonas - SHARM, duke përdorur një vegël për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik.

1 Regjistrimi i lëndëve nga fusha e mbrojtjes së të drejtës për barazi në përputhje me Rregulloren e procedurës së gjykatës dhe praktikën e regjistrimit në gjykata

Në lëndët e shkeljes së të drejtës për barazi dhe mbrojtje nga diskriminimi, problemi është vetë regjistrimi duke filluar procedurën dhe evidentimin e lëndës, dhe pastaj paraqiten vështirësi në marrjen e vendimeve të marra. Evidentimi i lëndëve në gjykata bëhet në regjistrin e gjykatave nga nëpunës të autorizuar të gjykatës, përmes sistemit të automatizuar kompjuterik për menaxhimin e lëndëve gjyqësore, ndërsa lëndët grupohen sipas karakteristikave të caktuara në llojet e lëndëve^[4].

Prezantimi nr. 1: Rregulla për regjistrimin e lëndëve në gjykata

Sipas Rregullores gjyqësore, llojet e lëndëve ndahen sipas llojit të gjykatës dhe sipas llojit të rrethit. Në varësi të fushës dhe bazës, lëndët mund të ndahen në nëntipe të lëndëve^[5], dhe karakteristikat kryesore të një regjistruesi janë: emri, emërtimi, cilit lloj ose nënloji i përket lënda dhe cilës njësi organizative (departamenti).

Karakteristikat shtesë të regjistrimit që përdoren për të konfiguruar hyrjen e lëndës në regjistra janë: për të miturit, përfshihet kontrolli i viteve të personave; për paraqitësin më të zakonshëm - propozimin e një paraqitësi të rregullt; për emrin e palës kundërshtarë siç thirret pala kundërshtarë në lëndën (i akuzuari, i pandehuri, etj.); për mënyrën e zgjidhjes së lëndëve: me vendim, me akt që nuk është vendim (akte të ndryshme)^[6].

Lëndët janë grupuar sipas karakteristikave të caktuara në lloje të lëndëve. Llojet e lëndëve janë të unifikuara për të gjitha gjykatat dhe libri i kodeve mbahet në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Llojet e lëndëve ndahen sipas llojit të gjykatës dhe sipas llojit të rrethit. Në varësi të fushës dhe bazës, lëndët mund të ndahen në nëntipe të lëndëve.^[7]

Çështjet civile, përfshirë procedurat gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës për barazi, regjistrohen si tipe të çështjeve gjyqësore. Në rastet e çështjeve civile, regjistrohet gjithashtu një nëntip i lëndës, i cili sipas Rregullores së Procedurës përfshin mosmarrëveshjet pronësore me një regjistër të shënuar P1, një regjistër të shënuar për mosmarrëveshjet familjare P3, mosmarrëveshjet e detyrimeve P4, mosmarrëveshjet tregtare MT, mosmarrëveshjet e punës MP, çështje të ndryshme të çështjeve gjyqësore RP, regjistruetit për çështje të ndryshme tregtare ÇTT, regjistër për mosmarrëveshje të ndryshme të punës, etj.

Në Gjykatën e apelit procedurat evidentohen si çështje gjyqësore, lëndë qytetare të shkallë së dytë – GZH, çështje të shkallës së dytë për mosmarrëveshjet tregtare – TSHZ, lëndë të shkallës së dytë nga mosmarrëveshjet e marrëdhënieve të punës - ROZH etj.

Mbrojtja gjyqësore për përcaktimin e shkeljes së të drejtës për barazi dhe mbrojtje nga diskriminimi kryhet në përputhje me rregullat e përgjithshme të procedurës civile, përveç në rastet kur Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi - LPMD, rregullohet ndryshe.

4 Rregullorja e gjyqësorit, “Gazeta zyrtare e RM” nr. 66/2013, nr. 114/2014, neni 239.

5 Ibid., neni 239.

6 Ibid., neni 240.

7 Ibid., neni 239.

Për shkak të faktit se LPMD është lex specialis, ai vendos një procedurë të veçantë gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi.

Nga analiza e informatave mbi numrin e procedurave gjyqësore për përcaktimin e diskriminimit/shkeljes së të drejtës për barazi në periudhën 2011-2019 të kryera në të gjitha gjykatat në vend, mund të konkludohet se mos ekzistenca e bazave të diskriminimit në arsyet e deklaruara të regjistrimit dhe në sehnjat në Rregulloren gjyqësore i lënë hapësirë gjyqtarëve për të interpretuar, pra për të zgjedhur mënyrën në të cilën do të regjistrohen këto lëndë. Në të njëjtën kohë, fitohet një pasqyrë e mosunifikimit dhe praktikës individuale të regjistrimit të këtyre lëndëve, për shkak të së cilës nuk mund të presim të dhëna të plota kur praktika e regjistrimit ndryshon në gjykata, gjë që e bën më të vështirë kërkimin e lëndëve.

Prenazantmi nr. 2: Informatat e marra për numrin e procedurave gjyqësore në bazë të diskriminimit/shkeljes së të drejtës për barazi të kryer në periudhën 01.01.2011 - 31.12.2019 në gjykatat në vend

Një pjesë e gjykatave nuk kanë kryer procedura të tilla në periudhën e kërkuar^[8] ose nuk kanë asnjë lëndë të vetme të regjistruar në bazë të diskriminimit/shkeljes së të drejtës për barazi/shkelje të së drejtës për trajtim të barabartë.^[9]

Në Gjykatën themelore Manastir, lëndët në periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2019 në bazë të diskriminimit regjistrohen sipas regjistrit P4, ndërsa për periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2016 nuk ka të dhëna në sistemin AKMIS, sepse lëndët nuk janë regjistruar në atë bazë.

Në Gjykatën themelore civile Shkup, lëndët në bazë të diskriminimit/shkeljes së të drejtës për barazi regjistrohen në Departamentin për kontestet pronësore, mosmarrëveshjet me vlerë të vogël, mosmarrëveshjet familjare dhe në Departamentin për kontestet e punës.^[10]

Në Gjykatën themelore Shtip, katër lëndë janë regjistruar për arsye të diskriminimit, dhe një lëndë, e cila nuk është zgjidhur akoma, për shkak të ngacmimit në vendin e punës.^[11]

Dy lëndë janë regjistruar në Gjykatën themelore në Dibër, MP. Nr. 26/13 dhe MP. Nr. 1/15^[12]. Një lëndë është regjistruar në Gjykatën themelore në Strugë. MP.nr 327/16.

Lëndët në Gjykatën e apelit të Shkupit nuk janë të regjistruara në sistemin AKMIS si procedurë gjyqësore në bazë të diskriminimit/shkeljes së të drejtës për barazi.^[13]

Dy aktgjykime janë regjistruar në Gjykatën e apelit Shtip, ROZH-156/14 dhe ROZH 50/19, si dhe vendimet ROZH 350/18 dhe 372/19.

8 Përgjigje nga Gjykata themelore Vinicë QLI – 1/20 nga data 09.01.2020; Gjykata themelore Kavadar QLI. nr. 8/2019 nga data 25.12.2019; Përgjigje nga Gjykata themelore Koçanë QLI. nr. 15/19 nga data 23.12.2019.

9 Përgjigje nga Gjykata themelore Tetovë SU 03. nr. 7/20 nga data 13.01.2020; Përgjigje nga Gjykata themelore Gjevgjeli QLI. nr. 9/19 nga data 03.01.2020; Gjykata themelore Kërçovë QLI. nr. 12/2019 nga data 31.12.2019; Gjykata themelore Negotinë SU.01. nr. 37/19 nga data 26.12.2019; Përgjigje nga Gjykata themelore Kriva Pallankë QLI. nr. 9/19 nga data 27.12.2019; Përgjigje nga Gjykata themelore Krushevë SU. nr. 03-244/2019 nga data 27.12.2019; Përgjigje nga Gjykata themelore Kumanovë QLI -21/19 nga data 30.12.2019.

10 Përgjigje nga Gjykata themelore civile Shkup QLI. nr. 47/19 nga data 24.12.2019.

11 Përgjigje ndaj kërkesës nga Gjykata themelore Shtip SU-1094/19 nga data 14.01.2020.

12 Përgjigje ndaj kërkesës nga Gjykata themelore Dibër QLI. nr. 2/20 nga data 02.01.2020.

13 Përgjigje ndaj kërkesës nga Gjykata e apelit Shkup QLI nr. 29/19 nga data 03.01.2020.

1.1 Regjistrimi i lëndëve nga fusha e mbrojtjes së të drejtës për barazi në përputhje me Rregulloren e procedurës së gjykatës dhe praktikën e regjistrimit në gjykata

Vendimet që lidhen me fushën e marrëdhënieve të punës dhe baza në procesin gjyqësor për fillimin e tyre është shkelja e së drejtës për barazi dhe përcaktimi i diskriminimit, shënohen me MP^[14], dhe zakonisht regjistrohen si: lloji i lëndës - çështja gjyqësore, lloji i bazës - marrëdhëniet e punës, fusha civile, me nëntip të lëndës - mosmarrëveshjet e punës dhe baza - ndalimi i diskriminimit. Megjithatë, ka raste kur aktgjykimi, përkatësisht procedura kërkon të vendosë diskriminim, dhe procedura zhvillohet si një mosmarrëveshje pune në bazë të "llojeve të tjera të punësimit".^[15] Gjithashtu, një pjesë e madhe e vendimeve që janë regjistruar si marrëdhënie pune, dhe të cilat kërkojnë, d.m.th. është marrë një vendim për të përcaktuar shkeljen e së drejtës për barazi, regjistrohen në bazë të kompensimit të dëmit nga marrëdhënia e punës^[16].

Megjithëse sipas Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, baza e diskriminimit janë: raca, ngjyra e lëkurës, origjina, kombësia ose etnia, seksi, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në një grup të marginalizuar, gjuha, shtetësia, prejardhja sociale etj.,^[17] të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në procedurat për mbrojtjen e të drejtës për barazi, gjykatat nuk i regjistrojnë fare këto informata gjatë regjistrimit të lëndëve.

Vërehen vështirësi gjatë kërimit dhe aksesit deri te disa vendimeve gjyqësore sepse vendimet për procedurat për mbrojtje nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës të regjistruara nën shenjën MP janë regjistruar në të njëjtën mënyrë, megjithëse ato i referohen bazave të ndryshme të diskriminimit.^[18]

Gjatë kontrollit të vendimeve, përcaktohen disa mospërputhje, d.m.th. lëndët që i referohen përcaktimit të diskriminimit nuk regjistrohen në bazë të ndalimit të diskriminimit, por në bazë të anulimit të vendimit,^[19] në bazë të mosmarrëveshjeve tjera të punës^[20] ose në bazë të zgjidhjeve tjera nga marrëdhëniet e punës,^[21] derisa baza e diskriminimit nuk është e pranishme. Është shqetësuese që procedurat për anulimin e vendimit të punëdhënësit për shkak të, përkatësisht me një kërkesë për përcaktimin e diskriminimit në bazë të statusit personal - shtatzënisë, regjistrohen si mosmarrëveshje punësimi në bazë të anulimit të vendimit, pa e regjistruar diskriminimin si bazë.^[22]

14 Aktgjykime të Gjykatës themelore civile Shkup, MP-904/15; MP-178/17; MP-464/16; MP-2844/11; MP-1215/16; MP-1356/16; MP-618/15; MP-1305/14; MP-980/17; MP-974/14; MP-45/12; MP-2034/17; MP-1227/10; MP-66/16; MP-881/14; MP-1121/16; MP-1574/16; MP-430/09; MP-441/09; MP-440/09; MP-437/09; MP-445/09; MP-439/09; MP-435/09; MP-436/09; MP-438/09; MP-432/09; MP-442/09; MP-883/14; MP-900/14; MP. nr. 410/18; MP-1359/14; MP-1226/14; MP-1332/15; MP-1710/10; MP-927/1; MP-97/15.

15 Vendim MP -2235/11 i Gjykatës themelore Shkup II.

16 Aktgjykim PO-814/14 i Gjykatës themelore Shkup II

Aktgjykim MP-971/14 i Gjykatës themelore Shkup II

Aktgjykim MP -784/14 i Gjykatës themelore Shkup II

Aktgjykim MP -972/14 i Gjykatës themelore Shkup II

Aktgjykim MP -531/13 i Gjykatës themelore Shkup II.

21 Vendimi MP nr. 934/14 i Gjykatës themelore Shkup 2 – Shkup nga data 17.09.2014, që ka të bëjë me procedurën për vërtetimin e pozitës së pavolitshme lidhur me kandidatin e zgjedhur, është regjistruar në bazë tjetër të vendimeve nga marrëdhënia e punës.

22 Vendimi MP-1076/17 i Gjykatës themelore Shkup II nga data 30.05.2017.

Vërehet gjithashtu një praktikë e regjistrimit të lëndëve të ndryshme që janë të ngjashme dhe kanë të njëjtën bazë.^[23]

Nga praktika gjyqësore në fushën e mbrojtjes së të drejtës për barazi, ka vendime për vendosje në vendin e punës ku kërkohet të përcaktohet diskriminimi dhe ngacmimi në vendin e punës, por në aktgjykim thuhet se gjykata nuk u mor me përcaktimin e pretendimeve të avokatit të paditësit që diskriminimi, d.m.th. mobingu i paditësit është duke u kryer, dhe se përcaktimi i mobingut, d.m.th. diskriminimi, do t'i nënshtrohej një procedure tjetër pas një procesi gjyqësor.^[24] Ka edhe lëndë kur baza është kompensimi i dëmit nga marrëdhënia e punës, dhe aktgjykimi përcakton se i pandehuri ka shkelur të drejtën e paditësit me trajtim të pabarabartë dhe ka kryer diskriminim të drejtpërdrejtë në bazë të moshës në punë dhe punësimin, me anë të rivendosjes.^[25]

Lëndët e regjistruara në bazë të mosdiskriminimit janë të rralla, por ato përsëri mund të gjenden. Kjo konfirmon faktin se, megjithëse nuk ka një lloj të veçantë të regjistrimit për procedurat diskriminuese, ekziston ende një mundësi në sistemin elektronik në gjykatë për të regjistruar procedurat në këtë mënyrë. Një praktikë pozitive në këtë drejtim është vërejtur në një lëndë të regjistruar në nën-lëndën e mosmarrëveshjeve të punës, dhe baza është ndalimi i diskriminimit,^[26] si dhe në rastet nga fusha civile në nën-llojin e marrëdhënieve të punës të cilat regjistrohen në bazë të ndalimit të diskriminimit.^[27]

23 Aktgjykimi MP-1057/09 i Gjykatës themelore Shkup II, i cili i referohet përcaktimit të diskriminimit dhe mobingut, është ngritur në bazë të një padie kundër punëdhënësit për shkelje të detyrimeve kontraktuale dhe detyrimeve të tjera të punës, ndërsa Vendimi MP-89/13 i Gjykatës themelore Shkup II, e cila i referohet vendosjes së diskriminimit dhe mobingut në vendin e punës, regjistrohet në bazë të mobingut.

24 Aktgjykimi MP-739/15 i Gjykatës themelore civile Shkup nga data 20.10.2015.

25 Aktgjykimi MP-1969/17 i Gjykatës themelore civile Shkup nga data 20.03.2018.

26 Në lëndën MP-433/12 të Gjykatës themelore Shkup II vërtetohet shkelja e të drejtës për trajtim të barabartë dhe ndalesa për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme të diskriminimit.

27 Fjala është për lëndë që kërkojnë përcaktimin e shkeljes së të drejtës për trajtim të barabartë me miratimin e Marrëveshjes kolektive nga data 08.03.2012 dhe akte të tjera individuale që lidhen me dhënien e jubileut të papaguar për 10 vjet shërbim.

1.2 Procedurat në lidhje me shkeljen e së drejtës për barazi të evidentuar në regjistrin P1 dhe P4

Procedurat në lidhje me shkeljen e të drejtës për barazi, të cilat janë në fusha të tjera të çështjeve civile, regjistrohen si çështje gjyqësore me një regjistër të shënuar P1 - mosmarrëveshjet pronësore dhe P4 - mosmarrëveshjet e detyrimeve.

Me shenjë P4 si mosmarrëveshje detyrimesh e bazuar në kompensimin e dëmit jomaterial gjithashtu regjistron procedurat që kërkojnë të vendosin diskriminimin dhe shkeljen e së drejtës për lirinë e lëvizjes nga shërbimet kufitare në Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV (MPB), të cilat gjatë kontrolleve kufitare parandaluan që shtetasit maqedonas të largoheshin nga vendi me arsyetimin se ekzistonte dyshimi se këta shtetas do të abuzonin me regjimin pa viza dhe do të kërkonin azil në disa nga vendet e Shengenit. Ky veprim filloi në vitin 2011 dhe në shumicën e rasteve preku qytetarët e komunitetit etnik rom.^[28] Kishte një numër të madh procedimesh në të cilat MPB ishte paditur për veprime të paligjshme dhe praktikën e profilizimit të pikave kufitare dhe në disa prej tyre gjykatat njohën diskriminimin.^[29]

Një shkelje e tillë gjithashtu referohet nga aktgjykimi që refuzon si të pabazuar pretendimin që kërkon të vërtetohet se MPB ka shkelur të drejtën për trajtim të barabartë, d.m.th. veprimi i ndërmarrë çoi në shkelje të së drejtës për barazi në veprim, e cila është regjistruar si kompensim për dëmin jomaterial në rast të prishjes së nderit dhe përhapjen e pretendimeve të pavërteta,^[30] ndryshe nga rastet e tjera që lidhen me të njëjtin veprim, të cilat regjistrohen në bazë të kompensimit të dëmit jomaterial.

Procedura për përcaktimin e shkeljes së të drejtës për trajtim të barabartë - diskriminimi dhe veçimi në ushtrimin e së drejtës për arsimim të studentëve romë, ka një regjistër të shënuar P4-932/17, pra si një mosmarrëveshje detyrimi bazuar në lloje të tjera të detyrimeve, dhe padia kërkon të përcaktojë që të pandehurit, secili brenda juridiksionit të tyre, shkelën të drejtën e barazisë në arsimimin e studentëve romë në Republikën e Maqedonisë, duke diskriminuar studentët romë për shkak të përkatësisë etnike.

Një procedurë e cila është regjistruar gjithashtu me subjektin e mosmarrëveshjeve të detyrueshme dhe bazën e llojeve të tjera të marrëdhënieve të detyrueshme, është procedura me të cilën kërkohet të përcaktohet se të pandehurit kundër paditësve si anëtarë të një grupi të marginalizuar në shoqëri - anëtarë të komunitetit kombëtar rom në RMV - kanë kryer diskriminim, duke shkelur kështu të drejtën për trajtim të barabartë në kryerjen e detyrave zyrtare.^[31]

Një rast i regjistruar me një nëntip të lëndës për mosmarrëveshje pronësore, lloji i bazës së marrëdhënieve të detyrueshme dhe baza e borxhit, i referohet kompensimit për dëmin e diskriminimit (neni 10, dhe në lidhje me nenin 6 të Ligjit për marrëdhënie pune) për kontributin e pensionit të papaguar dhe të sigurimit të aftësisë së kufizuar. Paditësit konsideruan se ishin diskriminuar sepse i pandehuri si punëdhënës lidhi një kontratë pune me 23 persona të listuar në listën e personave të siguruar dhe nuk bëri të njëjtën gjë me paditësit për shkak të rrethanave personale, gjë që u shkaktoi atyre dëm material.

28 Opinion ligjor për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e parandalimit të largimit nga territori i RM personave shtetas të RM për shkak të dyshimit për abuzim të regjimit pa viza midis RM dhe zonës Shengen, Shoqata e avokatëve të rinj të Maqedonisë, 5 tetor 2016, gjendet në: <https://cutt.ly/ShGBiVV>

29 P4-171/15, P4-155/15, P4-171/15, P4-42/16, P4-268/20, P4-64/17, P4-641/17, P4-1318/15, P4-709/15, P4-730/15, P4-625/17.

30 P4-216/16 nga data 28.04.2017.

31 Aktgjykimi P4-68/18 i Gjykatës themelore civile Shkup nga data 26.07.2019.

Më shpesh, procedurat për mbrojtjen e të drejtës së barazisë regjistrohen si procedura në fushën civile, lloji i çështjes gjyqësore, nëntip lënda e çështjes gjyqësore dhe lloji i bazës së mosmarrëveshjes, bazuar në kompensimin e dëmit jomaterial - të tjera^[32], por ka përjashtime në të cilat regjistrohen lëndët me një nëntip tjetër, lloji i bazës dhe baza. Në këtë kuptim, ekziston një vendim që tregon tërheqjen e padisë me të cilën paditësi kërkoi kompensim për shkak të diskriminimit, i cili është regjistruar në nëntipet lënda e mosmarrëveshjes pronësore, llojin e bazës së marrëdhënieve të detyrimit dhe bazën e borxhit.^[33] Lënda që i referohet shkeljes së të drejtës për trajtim të barabartë duke kryer diskriminim të drejtpërdrejtë me një vendim të marrë nga i pandehuri regjistrohet si një mosmarrëveshje pronësore, dhe baza për lloje të tjera mosmarrëveshjesh,^[34] dhe një lëndë që i referohet diskriminimit në një procedurë për ushtrimin e së drejtës për shtesën e fëmijëve është e shënuar në bazë si lloje të tjera të marrëdhënieve të detyrimit të nëntipit të mosmarrëveshjeve të detyrimit.^[35]

Procedura që kërkon përcaktimin e diskriminimit në bazë të gjinisë - d.m.th. paditësi konsideroi se IP Qendra ndërkomunale për çështjet sociale të Qytetit të Shkupit duke miratuar akte i shkelte të drejtën e tij për trajtim të barabartë në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e jetës së tij familjare, duke ruajtur lidhjet familjare me vajzën e tij - regjistrohet në bazë të: vlefshmërisë së dokumenteve dhe depozitave gjyqësore, dhe bazës: mbi baza tjera.^[36]

2 Pasqyra e aksesit të vendimeve gjyqësore për mbrojtjen e së drejtës për barazi në portalin gjyqësor

Portali www.sud.mk është një bazë e të dhënave e centralizuar e gjykatave në vend ku vendimet e gjykatave mund të kërkohen nga të gjitha gjykatat në vend. Është e rëndësishme të sigurohet një përmbledhje e efikasitetit dhe funksionalitetit të portalit në lidhje me disponueshmërinë e vendimeve gjyqësore në procedurat e diskriminimit.

Kërkimi i vendimeve gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës së barazisë në portal është i vështirë për shkak të mënyrës së regjistrimit të tyre sipas regjistrit gjyqësor, përkatësisht mënyrës së evidentimit në gjykata. Mangësia vërehet në procesin e evidentimit të procedurave, si dhe në mundësinë e përdorimit të opsioneve për kërkim të shpejtë dhe të lehtë. Pas publikimit të vendimeve në portalin gjyqësor, nuk ka asnjë mundësi për të kërkuar në baza diskriminuese, format dhe llojet e diskriminimit dhe të dhëna të tjera, gjë që është jashtëzakonisht e rëndësishme në raste të tilla, dhe është një pengesë për aftësinë për të përpunuar të dhëna dhe për të analizuar praktikën gjyqësore. fillimin e procedurës së njëjtë ose të ngjashme.

Gjatë kërkimit në portalin e gjykatës në seksionin e vendimeve të gjykatave, ekziston një mundësi për të specifikuar një Gjykatë, me mundësinë për të zgjedhur gjykatën, një mundësi për numrin e lëndës dhe nga - deri në datën e vendimit. Seksioni i kërkimit të avancuar ofron mundësitë për fitjen e gjyqtarit, fushën ligjore me mundësinë e zgjedhjes së njërës nga fushat e dhëna, llojin e lëndës dhe nëntipin e lëndës. Në seksionin e kërkimit

të avancuar, është e mundur të zgjidhni "llojin e bazës", ku diskriminimi nuk është një nga opsionet, ndryshe nga mbi 80 baza të listuara, të tilla si Gjuetia, Transmetimet, Peshkimi dhe shumë të tjera. Portali gjithashtu ofron mundësinë e kërkimit sipas llojit të personit, kategorisë, emrit dhe mbiemrit/emrit të një personi juridik, rolit, kategorisë, vendimit, si dhe mundësinë e kërkimit të tekstit me fjalë kyçe.

Personat gjatë kërkimit shpesh nuk janë në gjendje të kenë të gjitha informacionet individuale në lidhje me vendimin, siç janë gjyqtari, numri i vendimit, etj. kështu që më shpesh personat, të cilëve u është shkelur e drejta e barazisë kërkojnë vendimet me fjalë kyçe, sepse baza diskriminimi nuk është i pranishëm.

Për qëllimet e përpilimit të këtij dokumenti, ne kemi kryer një test të kërkimit në portal. Rezultatet janë shfaqur në Prezantimin nr. 3

Prezantimi nr. 3: Testimi i portalit sud.mk

E zgjedhëm Gjykatën themelore civile Shkup, në seksionin përfushën, ne nuk zgjedhim opsionet e dhëna sepse procedurat për mbrojtje nga diskriminimi mund të shfaqen në zonën civile, zonë civile - vlerë e vogël, çështje gjyqësore dhe çështje gjyqësore - vlerë e vogël. Nëse bëjmë një zgjedhje në njërin nga opsionet e llojit të lëndës, nuk do të marrim të dhëna të plota sepse procedurat për mbrojtje nga diskriminimi janë regjistruar si çështje gjyqësore - vlerë e vogël, por shpesh si punë, sepse ato i referohen diskriminimit në vendin e punës. Për atë arsye, ne do të bëjmë kërkimin duke zgjedhur gjykatën, fushën ligjore dhe duke futur një fjalë kyçe - diskriminim.

Me këtë përzgjedhje fituam 176 rezultate, pra 176 vendime në të cilat përmendet termi diskriminim. Vihet re se disa nga këto vendime nuk i referohen aspak konstatimit të shkeljes së të drejtës për barazi dhe ka procedura që nuk i referohen arsyeve të diskriminimit,^[37] por kompensimit të dëmit jomaterial nga fyerja dhe shpifja për shkak të tekstit: "Nëpërmjet mobingut, bazuar në diskriminimin politik, ata kërcënojnë të gjithë disidentët dhe përpiqen të krijojnë një atmosferë të largimit nga puna."^[38] Pikërisht numri i madh i rezultateve të kërkimit që nuk përputhen me parametrat e dhënë, është problemi i parë me të cilin përballlemi.

Përveç kësaj, gjatë kërkimit kemi gjetur një zgjidhje që i referohet shkeljes së të drejtës për barazi, e cila është regjistruar në nënllojet që i nënshtrohen mosmarrëveshjeve tregtare, dhe bazat - lloje të tjera të bazave. Procedura kërkon që gjykata të përcaktojë që paditësi si person i përgjegjshëm në personin juridik vuan diskriminim me vendimet e gjykatës,^[39] si dhe të marrë një vendim që e shpall gjykatën të paaftë në një mosmarrëveshje të filluar nga një subjekt privat për të hequr dispozitat diskriminuese të ligjit, regjistruar si një mosmarrëveshje tregtare, bazuar në lloje të tjera të bazave.^[40]

37 Vendimi P4-163/19 i Gjykatës themelore civile Shkup për vërtetimin e anulimit të Marrëveshjes dhe mbrojtjes të drejtave personale të caktuara me Kushtetutën e RM dhe me dokumentet ndërkombëtare dhe evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

38 Vendimi P5-61/17 i Gjykatës themelore Shkup 2 – Shkup nga data 14.06.2018.

39 Vendimi MT-388/15 i Gjykatës themelore Shkup II nga data 30.07.2015.

40 Vendimi MT-450/16 i Gjykatës themelore civile Shkup nga data 28.10.2016.

Nga testimi i portalit sud.mk kemi konkluduar se vendimet për procedurat e diskriminimit nuk mund të kërkohen sipas fushave për shkak të praktikës jo konsistente të regjistrimit të lëndëve të tilla në gjykata. Kërkimi i vendimeve të gjykatës me fjalë kyçe jep një numër rezultatesh. Kriteri i vetëm me të cilin merren rezultatet është fjala kyçe që duhet përmendur në dokument. Prandaj, një kërkim për fjalën kyçe "diskriminim" jep rezultate që nuk kanë të bëjnë fare me procedurat diskriminuese. Kjo kontribuon në uljen e efikasitetit dhe funksionalitetit të sistemit të kërkimit të vendimit gjyqësor dhe në mënyrë të konsiderueshme e ndërlikon hulumtimin në një fushë specifike.

3 Konkludime dhe rekomandime

Analiza e evidenimit të lëndëve gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës për barazi, si dhe disponueshmëria e vendimeve gjyqësore, tregon mangësitë e mëposhtme:

Rregullorja e gjykatës nuk parashikon shënime të veçanta për regjistrimin e lëndëve në lidhje me konstatimin e shkeljes së të drejtës për barazi.

Rregulloret për regjistrimin e lëndëve nuk e njohin ndalimin e diskriminimit si një lloj baze ose si bazë, dhe përveç kësaj rregulla të tilla nuk përfshijnë mundësinë që rastet për mbrojtje nga diskriminimi të regjistrohen në bazë të arsyeve të diskriminimit të përcaktuara në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Kjo strukturë ligjore çon në një praktikë të unifikuar të regjistrimit të lëndëve. Si rezultat i gjithë kësaj, kërkimi i vendimeve për mbrojtje nga diskriminimi në portalin sud.mk, si një bazë e centralizuar e vendimeve gjyqësore, e ndërlikon hulumtimin e praktikës gjyqësore në procedura të tilla dhe rezulton në një numër vendimesh gjyqësore, disa prej të cilave nuk kanë lidhje fare, duke përcaktuar shkeljen e së drejtës për barazi.

Për shkak të kësaj, rekomandimet e mëposhtme mund të bëhen për të lehtësuar aksesin në vendimet e gjykatës për mbrojtje nga diskriminimi, d.m.th. zbatimin e njërit prej dy modeleve të mëposhtëm.

- ◆ Modeli i parë përfshin plotësimin e Rregullores gjyqësore me një shenjë të veçantë për regjistrimin e lëndëve për mbrojtje nga diskriminimi, futjen e ndalimit të diskriminimit si bazë, dhe prezantimin e bazave të përcaktuara në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi si bazë për regjistrimin e lëndëve gjyqësore.
- ◆ Modeli i dytë e ruan zgjidhjen ekzistuese të ofruar në Rregulloren gjyqësore së me të cilën lëndët regjistrohen nën çështje gjyqësore, marrëdhënie pune, mosmarrëveshje detyrimesh, etj., por do të përfshinte ndalimin e diskriminimit si bazë dhe bazat e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi si bazë për regjistrim të lëndëve gjyqësore.

Duke e modifikuar praktikën aktuale të regjistrimit të lëndëve, do të arrihet një evidentim dhe regjistrim më gjithëpërfshirës dhe i unifikuar i këtyre mosmarrëveshjeve. Kjo do të rezultojë në një kërkim më të lehtë të vendimeve në portalin sud.mk dhe me mundësinë për të analizuar mbrojtjen gjyqësore mbi një bazë specifike të diskriminimit. Ai gjithashtu do t'i siguronte shtetit akses në të dhënat statistikore, të cilat do të jenë veçanërisht të rëndësishme në planifikimin e politikave shtetërore për parandalimin dhe zvogëlimin e diskriminimit në bazat mbi të cilat janë zhvilluar shumica e procedurave gjyqësore.

4 Lista e vendimeve të analizuara gjyqësore të vendit

Aktgjykimi P1-1121/13 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi P 1-789/13 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi P 4-1045/15 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi P 4-413/16 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi P 4-453/17 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi P 4-476/16 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi P 4-68/18 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP nr.1884/10 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1007/12 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1057/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1224/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1969/17 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-433/12 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-531/13 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-739/15 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-784/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-814/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-971/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-972/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-904/15 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup,
Aktgjykimi MP-178/17 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-464/16 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-2844/11 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1215/16 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
AktgjykimiMP-1356/16 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-618/15 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1305/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-980/17 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-974/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-45/12 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-2034/17 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1227/10 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-66/16 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup

Aktgjykimi MP-881/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1121/16 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1574/16 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-430/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-441/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-440/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-437/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-445/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-439/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-435/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-436/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-438/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-432/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-442/09 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-883/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-900/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP.nr.410/18 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1359/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1226/14 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1332/15 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-1710/10 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-927/1 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Aktgjykimi MP-97/15 i Gjykatës themelore Shkup II Shkup
Vendim P4-163/19 i Gjykatës themelore civile Shkup
Vendim P5-61/17 i Gjykatës themelore Shkup 2 Shkup
Vendim P-600/10 prej 21.12.2012
Vendim MP nr.934/14 i Gjykatës themelore Shkup 2 Shkup
Vendim MP-1076/17 i Gjykatës themelore Shkup II
Vendim MP-2235/11 i Gjykatës themelore Shkup II
Vendim MP-89/13 i Gjykatës themelore Shkup II
Vendim MP-934/14
Vendim MT-388/15 i Gjykatës themelore Shkup II
Vendim MT-450/16 i Gjykatës themelore civile Shkup

Bibliografia

„Resource Guide on Strengthening Judicial Integrity and Capacity“, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2011

“THE 2020 EU JUSTICE SCOREBOARD”, Komisioni Evropian, Luksemburg, 2020

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Gazeta zyrtare e RMV nr. 58/2020

Rregullorja gjyqësore, Gazeza zyrtare e RM nr. 66/2013, 114/2014

“Opinion ligjor për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e parandalimit të largimit nga territori i RM personave shtetas të RM për shkak të ekzistimit të dyshimit për abuzim të regjimit pa viza midis RM dhe vendeve të zonës Shengen”, Shoqata e juristëve të rinj maqedonas, 5 tetor 2016

Strategjia për reworkforma në sektorin e gjyqësorit për peirudhën 2017-2020, Ministria e Drejtësisë

Përgjigje ndaj Kërkesave për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Виница QLI – 1/20 nga data 09.1.2020

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Kavadar QLI.nr.8/2019 nga data 25.12.2019

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Tetovë SU 03.nr.7/20 nga data 13.01.2020

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Gjevgjeli QLI.nr.9/19 nga data 03.01.2020

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Kërçovë QLI.nr.12/2019 nga data 31.12.2019

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Negotinë SU.01.nr.37/19 nga data 26.12.2019

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Kriva Pallankë QLI. nr.9/19 nga data 27.12.2019

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Kumanovë QLI-21/19 nga data 30.12.2019

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore civile Shkup QLI.nr.47/19 nga data 24.12.2019

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Shtip SU-1094/19 nga data 14.01.2020

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Dibër QLI. nr.2/20 nga data 02.01.2020

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata e apelit Shkup QLI nr.29/19 nga data 03.01.2020

Vendimi MR-956/1

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Koçanë QLI .nr.15/19 nga data 23.12.2019

Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga Gjykata themelore Krushevë SU.nr.03-244/2019 nga data 27.12.2019

